



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3813 Prot.

Ballsh, më 27.07.2022

VENDIM

Nr. 43, Datë 26.07.2022

PËR

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 28.02.2022 “ PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 55, DATË 22.12.2020 “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË
SHPRONËSIMIT TË QYTETARËVE DASHNOR MALASI DHE VELEDIN MALASI
NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE TË BASHKISË MALLAKASTËR”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar, të VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në republikën e Shqipërisë”, të projektit “Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 24.02.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër”, si dhe referuar shkrësës nr. 18/2 prot., datë 28.06.2022, të Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 87/2 prot., datë 30.06.2022, të shkresës nr. 3720/1 prot., datë 15.07.2022, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 3520/1 prot., datë 19.07.2022,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 13, datë 28.02.2022 “ Për disa ndryshime në vendimin nr. 55, datë 22.12.2020 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Dashnor Malasi dhe Veledin Malasi në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër”.
2. Lënien në fuqi të të Vendimit nr. 55, datë 22.12.2020 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Dashnor Malasi dhe Veledin Malasi në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Administrimit, Zhvillimit të Territorit dhe Liçencave.
4. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

